



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2017 – Numri: 235

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 3 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 612, datë 26.12.2017	Për delegim kompetence..... 13089
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 82, datë 21.12.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 504, datë 24.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2015-613/234, datë 16.3.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2016-1901, datë 10.11.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 13089
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 83, datë 26.12.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 04, datë 8.4.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; nr. 79, datë 6.9.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2016-2219, datë 15.12.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 13095
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 84, datë 26.12.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1, datë 9.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 1148 (107), datë 6.3.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2015-2924, datë 26.11.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 13099
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 85, datë 26.12.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t’u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”..... 13103
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 86, datë 26.12.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 2857, datë 27.6.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-414, datë 7.4.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2857, datë 27.6.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në momentin e dhënies së vendimit nga Gjykata Kushtetuese..... 13104

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 87, datë 26.12.2017	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.....	13109
Urdhër i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 28.12.2017	Për delegim kompetencash.....	13112
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 19014, datë 20.12.2017	Mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare.....	13112

**URDHËR****Nr. 612, datë 26.12.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Arian Kraja, për çështjet e mëposhtme:

1. Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë: kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe t’i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

4. Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

5. Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

II. Këto kompetenca do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

IV. Ngarkohet z. Arian Kraja dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

VENDIM**Nr. 82, datë 21.12.2017****NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.9.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 39 Akti, që u përket:

KËRKUESI: Aleksandër Plepi

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të pajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 504, datë 24.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2015-613/234, datë 16.3.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2016-1901, datë 10.11.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.



BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës; nenet 27, 28, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 504, datë 24.10.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: “*Të deklarojë fajtor të pandeburin Aleksandër Plepi për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe në bazë të nenit 245/1, paragrafi i 2-të dhe 25 të Kodit Penal e dënonte me 1 vit burgim. Të pezullojë vuajtjen e dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur, në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, me kushtin që i pandeburi të mos kryejë veprë tjetër penale për një periudhë kohe prej 18 muajsh.*”.

2. Me vendimin nr. 10-2015-613/234, datë 16.3.2015, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs prokurori dhe kërkuar Aleksandër Plepi.

3. Me vendimin nr. 00-2016-1901, datë 10.11.2016, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, me arsyetimin se nuk përmbajnë shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

4. **Kërkuarisi Aleksandër Plepi** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

4.1. *Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.* Në procesin e zhvilluar në gjykatat e faktit janë marrë në shqyrtim vetëm

provat e paraqitura nga akuza. Vendimet e ndërmjetme të marra gjatë gjykimit nga gjykatat e faktit dhe arsyetimi i vendimit përfundimtar tregojnë se gjykata nuk është investuar fare për versionin e ngritur nga mbrojtja, duke referuar pa arsyetim dhe shkak ligjor provat që shfaqësonin të akuzuarit.

4.2. *Është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.* Gjykatat e faktit kanë demonstruar mjaftueshëm sjellje që i bëjnë të kenë vepruar në mënyrë të njëanshme. Ato kanë ndihmuar interesat e njëres palë (akuzës), duke mënjanuar nga gjykimi kategori provash të kërkuara nga mbrojtja që do të përmbysnin akuzën e ngritur.

4.3. *Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë.* Mosdëgjimi, mosshqyrtimi dhe mosmarrja nga gjykatat e këtyre provave të rëndësishme, ka paragjykuar fajësinë e kërkuarit, pasi ato e kanë filluar procesin me bindjen se ai është fajtor. Gjykatat e kanë zhveshur kërkuarin nga armët për t’u mbrojtur në proces, duke e konsideruar fajtor para dhënies së një vendimi përfundimtar.

4.4. *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë.* Gjykatat e faktit duke mos i pranuar efektisht për shqyrtim pretendimet e mbrojtjes, pra duke mos marrë në konsideratë trajtimin ligjor të pretendimeve të mbrojtjes për provokim të aktit kriminal, duke i refuzuar provat e mbrojtjes në lidhje me to, kanë mohuar të drejtën e aksesit. Kjo e drejtë është mohuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka pranuar shkaqet e ngritura në rekurs, pa dhënë asnjë lloj argumentimi ose arsyetimi se përse nuk plotësoheshin kërkesat e nenit 432 të KPP-së.

4.5. *Procesi gjyqësor është bazuar mbi të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme.* Bisedat e përgjuara nuk janë biseda të lira të personave, por të nxitura, të provokuara, të dirigjuara dhe të kontrolluara nga policia. Mbi këto transkriptime jokorrekte bisedash të përgjuara dhe në sajë të refuzimit të të gjitha provave shkresore që shërbenin për identifikimin e bashkëpunëtorëve të policisë të aktivizuar në ngjarje, gjykatat e faktit dhanë vendim dënimi për kërkuarin, duke u bazuar në esencë vetëm në provat e prokurorisë, në interpretime fjalësh e bisedash telefonike, edhe pse kishte prova të pakontestueshme që vërtetonin se fakti kriminal



ishte provokuar prej bashkëpunëtorëve të policisë të aktivizuar në ngjarje dhe e vërteta ishte krejt tjetër, që shpinte në rënien e akuzës së ngritur nga prokuroria. Gjykatat e faktit u gjendën përballë një morie provash që vërtetonin ekzistencën, rolin dhe lidhjet e bashkëpunëtorëve të policisë me ngjarjen, e mjaftueshme për të konstatuar se provat e akuzës ishin siguruar në rrugë të pandershme dhe antiligjore dhe se i gjithë procesi penal ishte një proces i montuar prej Policisë së Shtetit dhe i mbështetur nga prokuroria.

4.6. *Është cenuar parimi i gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.* Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur funksionin e saj si gjykatë ligji dhe jo fakti kur ka vërejtur mohim *on block* në procesin e zhvilluar në shkallët e ulëta të gjyqimit të të gjitha provave të mbrojtjes që përmbysnin akuzën e ngritur për kërkuesin, çështje kjo që i përket ligjit dhe jo faktit. Ajo duhej ta kthente çështjen për rishqyrtim për plotësimin e të metave të vendimeve gjyqësore, pasi nuk mund ta zgjidhte vetë në themel çështjen.

5. *Subjekti i interesuar,* Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar para Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1. Pretendimi për cenimin e parimit të deklarimit fajtor mbi bazën e mbledhjes së provave në mënyrë të paligjshme është i pabazuar. Deklarimet e kërkuesit janë vlerësuar nga gjykata si provë së bashku me. Në rastin në shqyrtim gjykatat i kanë mbështetur vendimet e tyre jo vetëm në provat e kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuesi, por edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjyqimit.

5.2. Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve nuk është i bazuar. Kërkuesit i është dhënë mundësia për t'u njohur me të gjitha provat e akuzës, si dhe për të paraqitur argumentet dhe provat në lidhje me çështjen në të gjitha shkallët e gjyqimit.

5.3. Vetë Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetuese.

5.4. Edhe pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nuk është i bazuar. Nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura në

kërkesë, nuk rezulton ndonjë e dhënë që të tregojë se gjykatat e zakonshme e kanë filluar procesin me paragykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në rastin në shqyrtim rezulton se gjykatat vendimet e tyre i kanë bazuar në një sërë provash, që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, duke u vlerësuar në unitet me njëra-tjetrën.

5.5. Pretendimi për paanshmëri në gjykim i referohet mënyrës së vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme dhe si rrjedhojë kërkuesi nuk ka arritur t'i ngrejë këto pretendime në nivel kushtetues.

5.6. I pabazuar është dhe pretendimi se është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në pjesën arsyetuese të vendimit ka bërë vlerësim për ekzistencën e shkaqeve të parashtruara në rekurs, duke arritur në përfundimin se shkaqet e pretenduara nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, duke mos i cenuar në thelb kërkuesit të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tij janë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të natyrës kushtetuese, rrjedhimisht ai legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtën e pretenduar si të cenuar nga vendimet gjyqësore.

B. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim

7. Kërkuesi pretendon se është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi në procesin gjyqësor janë marrë në shqyrtim vetëm provat e paraqitura nga akuza dhe gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim, megjithëse ka pasur kërkesë nga mbrojtja, prova të përcaktuara, vendimtare për çështje, duke i hequr mundësinë mbrojtjes të debatonte mbi ato prova. Sipas



kërkuesit, gjykatat e zakonshme, duke mos i pranuar efektivisht për shqyrtim pretendimet e mbrojtjes, pra duke mos marrë në konsideratë trajtimin ligjor të pretendimeve të mbrojtjes për provokim të aktit kriminal, duke i refuzuar provat e saj në lidhje me to, kanë cenuar edhe të drejtën e aksesit.

8. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar duke argumentuar se kërkuesit i është dhënë mundësia për t'u njohur me gjitha provat e akuzës, si dhe për të paraqitur argumentet dhe provat e tij në lidhje me çështjen në të gjitha shkallët e gjykimit.

9. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohej thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural më parë dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre (*shih vendimin nr. 28, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). 10. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre, është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit e konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimin nr. 2, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimin nr. 19, datë 19.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Bazuar në këto standarde Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim është i pabazuar. Kërkuesi është njoftuar për procesin gjyqësor në ngarkim të tij, i është dhënë mundësia të marrë pjesë në gjykim, të kundërshtojë provat e akuzës, të paraqesë provat në mbështetje të mbrojtjes së tij, si dhe është dëgjuar nga gjykata në lidhje me pretendimet e tij.

11. Gjykata vlerëson se gjykatat i kanë bazuar vendimet e tyre në provat e administruara në gjykim, duke dhënë argumente ligjore për të mbështetur qëndrimin e tyre të shprehur në dispozitiv dhe përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkuesit në procesin gjyqësor. Për këto arsye, ky pretendim nuk është i bazuar dhe duhet rrëzuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të aksesit në gjykim dhe të gjykatës së caktuar me ligj

12. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke mos pranuar shkaqet e ngritura në rekurs, pa dhënë argumentim ose arsyetim, ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur funksionin e saj si gjykatë ligji dhe jo fakti. Ajo duhej ta kthente çështjen për rishqyrtim për plotësimin e të metave të vendimeve gjyqësore, pasi nuk mund ta zgjidhte vetë në themel atë.

13. Në lidhje me të drejtën e aksesit, Gjykata ka vlerësuar se ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal dhe mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës e për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Neni 432 i KPP-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, kurse neni 433 i po këtij Kodi parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i rekursit vendoset nga kolegji në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencën e saj konstante, Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita



ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit nëpërmjet paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por kjo e drejtë nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe gjykimit nga një gjykatë e paanshme

16. Kërkuesi pretendon se gjykata e shkallës së parë në rigjykimin e çështjes ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, sepse e ka filluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, pa u bazuar në prova. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar duke argumentuar se nuk është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë shqyrtuar çështjen me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

17. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6/1 i Konventës. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi “i akuzuar për një veprë penale” është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014*). Në çështjen *Karaman kundër Gjermanisë*, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime.

19. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm vendimet e tyre i kanë bazuar në një sërë provash, të tilla si akte shkresore, thënie të dëshmitarëve etj., dhe se gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit ato nuk kanë arritur në asnjë konkluzion *apriori* për fajësinë e tij. Për pasojë, Gjykata, nisur edhe nga ecuria e procesit në tërësinë e tij, vlerëson se nuk rezulton që gjykata ta ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

20. Ndërsa në lidhje me paraqitjen dhe administrimin e provave në gjykim, në kuptim të parimit të barazisë së armëve dhe paanshmërisë, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (*shih vendimet nr. 7, datë 27.4.2005; nr. 16, datë 27.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural, si dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për këtë Gjykatë, sepse ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre. Gjykata ndërhyr vetëm në ato



raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për paanshmërinë dhe barazinë e armëve në gjykim i referohet mënyrës së vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme, si rrjedhojë edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

E. Për pretendimin e cenimit të parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

21. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet në prova të mbledhura në rrugë të paligjshme.

22. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar duke parashtruar se çdo provë në proces i është nënshtruar shqyrtimit e nuk ka pasur vlerë të paracaktuar si dhe gjykata i ka vlerësuar ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi.

23. Sipas jurisprudencës kushtetuese, tashmë të konsoliduar, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 57, datë 21.12.2012; nr. 47, datë 7.11.2011; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt ligjor është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm trajtohet edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur. Në çështjen *Bykov kundër Rusisë*, datë 10 mars 2009, § 90, GJEDNJ-ja ka theksuar se për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre.

24. Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo

zgjdhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe nisur nga ky parim sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në vlerësimin e Gjykatës kërkuesi i ka ngritur pretendimet në lidhje me mënyrën e marrjes së provave përpara gjykatave të zakonshme, dhe atij i është dhënë mundësia për të vënë në dukje mangësitë e provave nga ana formale, si dhe për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari



VENDIM
Nr. 83, datë 26.12.2017
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
 e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.10.2017
 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë
 dokumentesh, çështjen me nr. 48 Akti, që u përket:

KËRKUESE: Rovena Kalemi

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e
 Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me
 Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i
 vendimeve nr. 04, datë 8.4.2016, të Gjykatës së
 Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; nr.
 79, datë 6.9.2016, të Gjykatës së Apelit për
 Krime të Rënda; nr. 00-2016-2219, datë
 15.12.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së
 Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131/1/f dhe
 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së
 Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të
 Drejtat e Njeriut; nenet 28, 31, 71 e vijuese, të
 ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin
 dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të
 Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj,
 mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
 kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës,
 prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar,
 Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar
 rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në
 tërësi,

VËREN:

I

1. Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka
 filluar procedimin pasuror me nr. 11, datë
 10.12.2014 ndaj shtetasve Rovena Kalemi,
 E.M.N. (bashkëshorti i kërkuases) dhe B.C., për

kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve
 të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i
 Kodit Penal. Në vijim të këtij hetimi pasuror, në
 datën 20.7.2015 prokuroria i është drejtuar
 gjykatës me kërkesë për konfiskimin e një shume
 parash që ndodhej në llogarinë e kërkuases
 Rovena Kalemi.

2. Me vendimin nr. 04, datë 8.4.2016, Gjykata
 e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka
 vendosur: “*Pranimin e kërkesës. Konfiskimin e*
pasurisë që ndodhet në llogarinë ... në Bankën
“Raiffeisen Bank”, në emër të të paditurës Rovena
Kalemi në gjendje në valutë në shumën ... euro. Për
administrimin e pasurisë së sekuestruar ngarkohet z.
E.B., i cili është administrator i Agjencisë për
Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të
Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave”.

3. Me vendimin nr. 79, datë 6.9.2016, Gjykata
 e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur lënien
 në fuqi të vendimit nr. 04, datë 8.4.2016 të
 Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
 Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuësja ka
 paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Me vendimin nr. 00-2016-2219, datë
 15.12.2016, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka
 vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin
 se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon
 neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

5. **Kërkuësja Rovena Kalemi** i është drejtuar
 Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e
 vendimeve objekt kërkesë, duke parashtruar në
 mënyrë të përmbledhur këto pretendime për
 cenimin e së drejtës për një proces të rregullt
 ligjor:

5.1. Është cenuar parimi i barazisë së armëve,
 pasi gjykatat nuk kanë marrë prova që kanë qenë
 vendimtare për çështjen. Në çështjen në
 shqyrtim thelbi i debatit gjyqësor ka qenë nëse
 shumat e transferuara në favor të kërkuases kanë
 një burim të ligjshëm krijimi. Edhe pse në gjykim
 nga ana e bashkëshortit të kërkuases u paraqitën
 dokumentet përkatëse që provojnë burimin e
 pasurisë, ato nuk u morën parasysh nga gjykatat.

5.2. Është cenuar e drejta e pronës private.
 Shumat e transferuara në llogarinë e kërkuases
 janë provuar se janë fituar në mënyrë të ligjshme
 dhe se i janë dërguar asaj për qëllim të hapjes së
 një biznesi në Shqipëri. Bashkëshorti i kërkuases



ia ka dhuruar me vullnet të lirë, në këtë mënyrë ajo është bërë pronare e tyre me njëri nga mënyrat kushtetuese të fitimit të pronësisë.

5.3. Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi gjykatat që kanë shqyrtuar çështjen në ngarkim të kërkueses, e kanë filluar procesin me paragjykimin se ajo ka kryer një vepër penale, pa e mbështetur vendimin në prova direkte dhe indirekte. Për rrjedhojë, nga gjykatat është cenuar edhe parimi i paanshmërisë në gjykim.

5.4. Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjykatat nuk kanë arritur të shpjegojnë mjaftueshmërisht arsyet e themelit të dhënies së vendimeve të kundërshtuara, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, provave të administruara të cilat nuk janë analizuar në harmoni me njëra-tjetrën, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve në gjykim.

5.5. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar pretendimet për shkeljet procedurale të gjykatave të shkallëve më të ulëta, por është mjaftuar me përmbledhjen e fakteve të pasqyruara në rekurs, duke u shprehur se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në prapësimet me shkrim ka argumentuar sa vijon:

6.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës së barazisë së armëve gjatë procesit penal nuk qëndron. Nga vlerësimi i akteve të administruara në gjykim nuk rezulton që gjykatat e faktit të kenë vënë kërkuesen në pozitë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, për sa kohë që i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura prej saj nëpërmjet avokatit mbrojtës, duke u dhënë atyre përgjigje të arsyetuara.

6.2. Nuk qëndron pretendimi në lidhje me paanshmërinë e gjykatave, pasi kërkuësja nuk e ka ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues.

6.3. Nuk qëndron as pretendimi për cenimin e së drejtës së pronësisë, pasi nuk u provua me dokumente justifikuese ligjore ligjshmëria e shumës së parave të sekuestruara. E njëjta logjikë vlen dhe për pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

6.4. Nuk qëndron as pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se një

arsyetim i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e saj janë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu, ajo legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura bëjnë pjesë në rrethin e çështjeve që mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë. Kërkuësja nuk ka mjet tjetër në dispozicion përveç ankimit para kësaj Gjykate, për rrjedhojë ajo legjitimohet në kërkimet e paraqitura në këtë kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

8. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve në gjykim, pasi edhe pse në gjykim u paraqitën dokumentet përkatëse që provojnë burimin e pasurisë, si edhe dokumente të tjera të institucioneve belge, ato nuk u morën parasysh nga gjykatat. Po ashtu, ajo ka pretenduar cenimin e parimit të njëanshmërisë në gjykimin dhe të prezumimit të pafajësisë. Sipas kërkueses, edhe pse këto pretendime janë ngritur në rekurs, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë parasysh, por është mjaftuar me arsytimin se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore, duke cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

9. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Në



rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata është shprehur se është kompetencë e Kolegjit në dhomën e këshillimit që të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjeti procedural në dispozicion të kërkuessit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 65, datë 16.10.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në këndvështrim të së drejtës së aksesit, Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore, që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë

kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, kërkuessit i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës. Në vlerësimin e kësaj Gjykate, kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 65, datë 16.10.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se kërkuessa në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese. Me konkretisht, ajo ka pretenduar se gjykatat kanë mbajtur një qëndrim të njëanshëm, haptazi paragjykes dhe refuzues ndaj kërkesave për prova. Hetimet e kryera në shtetin belg për bashkëshortin e kërkuesses janë pushuar, pasi fakti i pretenduar nga autoritetet shqiptare nuk qëndron. Gjykatat nuk pranuan si prova dokumentet e lëshuara nga autoritetet belge, me pretendimin se nuk kishin vulë apostile, por u provua me anë të dy letërporosive se ato ishin të vërteta dhe autentike. Sipas saj, gjykatat nuk kanë marrë parasysh faktin se nuk ka pasur një vepër penale të gjykuar, nga e cila të dyshohet se rrjedhin shumat e konfiskuara. Për më tepër, vlerat monetare janë sekuestruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 744, datë 22.9.2014, i cili është ndryshuar me vendimin nr. 744/2, datë 21.12.2014 të po asaj gjykate, për mungesë të shkakut të ligjshëm. Në vendimmarrjen e tyre gjykatat e zakonshme nuk kanë dhënë asnjë argument në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009. Pavarësisht sa më sipër, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-2219, datë 15.12.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe ligjore.

14. Duke pasur parasysh natyrën e këtyre pretendimeve, si edhe bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej ta kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre dhe të jepte në përfundim një vendim të arsyetuar për të gjitha pretendimet



e kërkueses. Vetëm në këtë mënyrë do të garantohej e drejta e kërkueses për akses efektiv në gjykatë, sipas standardeve të vendosura tashmë nga jurisprudenca kushtetuese.

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për shkak të mosdhënies së një përgjigje përfundimtare ndaj pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, ka cenuar edhe të drejtën e kërkueses për të pasur një vendim të arsyetuar.

16. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Për pretendimet e tjera

17. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkueses, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së pronës private, parimit të kontradiktoritetit në gjykim, si edhe atij të prezumimit të pafajësisë, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të mësipërme të ngritura në rekurs.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2016-2219, datë 15.12.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari
Anëtar kundër: Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese Rovena Kalemijam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit nr. 00-2016-2219, datë 15.12.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

2. Sipas shumicës, në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkuesja ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, më konkretisht: gjykatat kanë mbajtur një qëndrim të njëanshëm, haptazi paragjykes dhe refuzues ndaj kërkesave për prova; hetimet e kryera në shtetin belg për bashkëshortin e kërkueses janë pushuar; nuk u pranuan si prova dokumente të lëshuara nga autoritetet belge, me pretendimin se nuk kishin vulë apostile; nuk ka pasur një vepër penale të gjykuar, nga e cila të dyshohet se rrjedhin shumat e konfiskuara; nuk janë dhënë argumente në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 Sipas shumicës, bazuar në natyrën e këtyre pretendimeve, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej ta kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre, duke dhënë në përfundim një vendim të arsyetuar për të gjitha pretendimet e kërkuesve, pasi vetëm në këtë mënyrë do të garantohej e drejta për akses efektiv në gjykatë dhe për të pasur një vendim të arsyetuar (*shih paragrafët 13-15 të vendimit*). Duke mos qenë dakord me këtë qëndrim të shumicës, në vijim do të paraqes argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

3. Në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 433 të KPP-së parashikohet se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë



mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelle e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Sipas jurisprudencës kushtetuese, në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe për këtë arsye shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkellen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 18, datë 6.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se në rastin konkret në shqyrtim, shumica duhej të ishte ndalur në verifikimin e pretendimeve të ngritura

nga kërkesja dhe vetëm nëse do të kishte dyshime në lidhje me cenimin e standardeve kushtetuese, atëherë duhej ta pranonte kërkesën dhe ta kthente çështjen për rishqyrtim, në mënyrë që të riparoheshin shkeljet e evidentuara në gjykimin kushtetues. Duke mbajtur një qasje të tillë formale, Gjykata e zhvesh dhomën e këshillimit nga kompetencat që i janë njohur asaj sipas dispozitave procedurale përkatëse, kompetenca që edhe në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se janë në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit.

6. Për sa më sipër, si gjyqtare në pakicë, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga Rovena Kalemi është e pabazuar dhe se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e saj.

Anëtar: Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 84, datë 26.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.10.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 49 Akti, që u përket:

KËRKUESI: Ylli Çelhaka

SUBJEKTE I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1, datë 9.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 1148 (107), datë 6.3.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2015-2924, datë 26.11.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe



funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 19 datë 24.3.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin Ylli Çelhaka për kryerjen e veprave penale “Vrasje me paramendim”, parashikuar nga neni 78/1 i Kodit Penal (KP), dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së. Përfundimisht, kjo gjykatë e ka dënuar kërkuesin me 20 (njëzet) vjet burgim.

2. Me vendimin nr. 141, datë 29.6.2000, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë.

3. Me vendimin nr. 471, datë 12.12.2000, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura si të pabazuara në ligj.

4. Bazuar në nenin 450/c të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kërkuesi Ylli Çelhaka ka paraqitur kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 00-2010-1084 (558), datë 2.6.2010, ka vendosur: “Prishjen e vendimeve nr. 471, datë 12.12.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 141 datë 29.6.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës, nr. 19 datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me një tjetër trup gjykues.”.

5. Me vendimin nr. 1 datë 9.4.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit Ylli Çelhaka për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, parashikuar nga neni 78/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ylli Çelhaka për kryerjen e

veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së gjykata e dënon të pandehurin Ylli Çelhaka me 20 vjet burgim.”.

6. Me vendimin nr. 1148 (107), datë 6.3.2014, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1, datë 9.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

7. Me vendimin nr. 00-2015-2924, datë 26.11.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së.

8. Në datën 4.4.2017, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë ka mbajtur procesverbalin e ekstradimit për kërkuesin Ylli Çelhaka për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit nr. 50, datë 17.3.2014, të nxjerrë për efekt të ekzekutimit të vendimit penal nr. 1, datë 9.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

II

9. **Kërkuesi Ylli Çelhaka** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor:

9.1 Është cenuar parimi i kontradiktoritetit, pasi gjatë gjykimit nuk janë pranuar kërkesat për marrjen e provave dhe vlerësimin e tyre, të cilat paraqisnin rëndësi për çështjen dhe vërtetimin e pafajësisë së kërkuesit. Vendimet gjyqësore mbështeten vetëm mbi dëshmitarët e akuzës dhe gjykatat, gjatë rigjykimit, nuk kanë pranuar thirrjen e dëshmitarëve të mbrojtjes.

9.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk ka bërë një hetim të gjithanshëm për t’i dhënë mundësi mbrojtjes për të provuar vërtetësinë e fakteve që pasqyrojnë fleta e regjistrit e qendrës spitalore në Capua Caserta, Itali.

9.3 Gjatë rigjykimit të çështjes, pas kthimit të saj nga Gjykata e Lartë, procesi penal në Gjykatën e Apelit është zhvilluar në mungesë të kërkuesit. Ai është përfaqësuar në gjykim nga avokati J.K., për të cilin ishte revokuar përfaqësimi me deklaratën noteriale të datës 2.7.2013. Në këto kushte kërkuesit nuk i është garantuar e drejta për t’u përfaqësuar nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij.



9.4 Vendimi i Kolegjit Penal për mospranimin e rekursit i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë. Kolegji Penal ishte i detyruar ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore, të shtjellonte dhe t'u jepte përgjigje shkaqeve të rekursit, duke marrë parasysh që në to jo vetëm pasqyrohen qëndrime të kundërta të gjykatave më të ulëta, por janë ngritur edhe pretendime për shkelje të natyrës procedurale dhe kushtetuese.

9.5 Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk plotëson standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Moskalimi i rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe mosdhënia përgjigje ndaj pretendimeve të ngritura në të cenonjë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

10. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, në prapësimet me shkrim ka argumentuar si vijon:

10.1 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim nuk qëndron, pasi gjykatat i kanë dhënë mundësi kërkuesit të paraqesë pretendimet e tij, si edhe prova të reja, të cilat pasi janë administruar dhe i janë nënshtruar ekspertimit, janë vlerësuar për marrjen e vendimit. Për kërkesat e tjera të pabazuara gjykatat janë shprehur në vendim për mospranimin e tyre. Kërkesat për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohen nga gjykatat e zakonshme dhe vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave. Argumentet mbi të cilat kërkuesi mbështet pretendimin për cenimin e këtij parimi kanë të bëjnë me çmuarjen dhe vlerësimin e provave nga ana e gjykatave.

10.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Kërkuesi e ka ushtruar të drejtën kushtetuese të ankimit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, ka vlerësuar se përfundimet e gjykatave të faktit janë rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor.

10.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të arsytimit, rezulton se vendimi i Kolegjit Penal përmban në pjesën hyrëse akuzën, disponimet e gjykatave më të ulëta, si edhe shkaqet e rekursit. Ndërsa në pjesën arsyetuese është vlerësuar se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore dhe Kolegji Penal ka bërë një proces vlerësimi nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

10.4 Për sa i takon pretendimit për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim për qëndrim të njëanshëm të trupës gjyqësore.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të përmbajtjes së neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit. Edhe pse ndryshimet ligjore në ligjin organik të Gjykatës janë miratuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, sipas nenit 86 të këtij ligji, zbatimi i afateve të reja ligjore ka filluar në datën 1 mars 2017. Bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkesa mban datën 29.5.2017, për rrjedhojë në rastin konkret afati i paraqitjes së saj do të llogaritet sipas rregullimeve të reja ligjore.

12. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se procesi gjyqësor i zhvilluar pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë, që i referohet edhe vendimeve të kundërshtuara në objektin e kësaj kërkesë, është bërë në mungesë të kërkuesit, i cili është përfaqësuar nga avokati J.K. Po ashtu, rezulton se në datën 4.4.2017, prokuroria ka mbajtur procesverbalin e ekstradimit për kërkuesin dhe zbatimin e urdhrit nr. 50, datë 17.3.2014 për ekzekutimin e vendimit penal nr. 1, datë 9.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Rezulton, gjithashtu, se në datën 28.4.2017 kërkuesi ka kërkuar nga Gjykata e Lartë informacion në lidhje me përfundimin e procesit gjyqësor të zhvilluar pranë kësaj gjykate. Me shkresën e datës 3.5.2017, kancelari i Gjykatës së Lartë ka informuar kërkuesin në lidhje me vendimin e marrë në dhomën e këshillimit, duke i bashkëlidhur edhe një kopje të tij. Në datën 29.5.2017 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën në shqyrtim.

13. Gjykata ka mbajtur qëndrimin se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë, që duhet bërë në përputhje me kërkesat



procedurale, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. E drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, të akuzuar për një veprë penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimin nr. 40 datë 6.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Pika 2 e nenit 33 të Kushtetutës përcakton se personat që i fshihen drejtësisë humbasin të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata. Në këtë kuptim, Kushtetuta ka bërë një zgjedhje, që ligjëron gjykimin e të pandehurit në mungesë kur plotësohen disa kushte: në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri të ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ai duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka theksuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kondicionohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se për efekt të provueshmërisë së fakteve, të cilat janë përcaktuese për marrjen e një vendimi të drejtë

nga ana e saj, mund të bazohet në çdo lloj mjeti të lejuar nga ligji procedural (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në kuptim të sa më sipër dhe referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata vëren se me deklaratën e datës 2.7.2013 kërkuasi ka revokuar përfaqësimin në gjykatë për avokatin J.K. Kjo deklaratë e lëshuar përpara noterit, i cili konfirmon faktin e paraqitjes personalisht të kërkuarit, është e mjaftueshme për të provuar faktin e pasjes dijeni për proceset gjyqësore të zhvilluara ndaj tij plus faktit që kërkuasi mbi kërkesën e tij për rishikim i është rihapur procesi penal. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kushtet për t'u pranuar për shqyrtim për shkak të tejkalimit të afateve ligjore.

17. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa në shqyrtim është paraqitur pas kalimit të afatit 4-mujor të parashikuar nga nenet 71/a, paragrafi 1, shkronja "b" dhe 86/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Për këtë arsye, kërkuasi Ylli Çelhaka nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 71/a dhe 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari



VENDIM
Nr. 85, datë 26.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “

në datën 23.11.2017, me sekretare Blerina Çinari, mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 61 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga znj. Lorana Kasapi dhe z. Eduart Saliaj.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Eduart Saliaj.

Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Erjola Sadushi, znj. Raimonda Islamaj dhe znj. Julia Guga.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t’u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 17, 18, 131/1, shkronjat “a” dhe “c”, si dhe 134, pikat 1/h dhe 2 të Kushtetutës; nenet 27, 45, 49, 50, 51, 51/a, 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Traktati për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, datë 25 tetor 2005; Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 23 prill 2009, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE”.

GJYKATA KUSHTETUESE

gjatë kërkimeve paraprake, pasi shqyrtoi kërkesën e kërkueses për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe vlerësimet e subjekteve të

interesuara, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës për pushimin e gjykimit të çështjes,

VËREN:

Me datën 15.11.2017, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës dhe ka kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes para zhvillimit të seancës plenare. Në nenin 31/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të shtuar me ligjin nr. 99/2016, parashikohet: “1. Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes. 2. Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik.

Në këtë rast Gjykata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë”.

Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa nuk plotëson kushtet e kërkuara të pasjes interes publik, prandaj nuk vazhdon me gjykimin e mëtejshëm të saj, dhe për rrjedhojë pushon gjykimin.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “c”, dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 31/b dhe 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të çështjes për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj



VENDIM

Nr. 86, datë 26.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.11.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 50 Akti, që u përket:

KËRKUES: Xhavit Pinari, Nadire Pinari, Qazim Pinari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Eleni Qordja, Gaqo Prushi, Nuri Prushi, Shpresa Tafaj, Lumturi Shehu, Nadire Nunaj, Nazmi Prushi, Bajram Pinari, Qerim Pinari, Vaje Pinari, Hajrije Pinari, Bedrije Koçi (Pinari), Bakushe Isaku (Pinari), Luljeta Tresa (Pinari), Shoqëria “Mateo Konstruksion” SHPK

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 2857, datë 27.6.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-414, datë 7.4.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 2857, datë 27.6.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në momentin e dhënies së vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

Faqe | 13104

VËREN:

I

1. Palët ndërgjyqëse në procesin gjyqësor civil janë trashëgimtarë të shtetasit M.P., i cili, në bazë të aktit të marrjes së tokës në pronësi, është trajtuar dhe pajisur nga ana e Komisionit të Tokës së fshatit Selitë me një sipërfaqe toke bujqësore, siç rezulton nga vendimet gjyqësore. Pala paditëse në procesin gjyqësor (subjektet e interesuara), duke pretenduar se është trajtuar me tokë bujqësore dhe se janë anëtarë të tokës bujqësore, ka paraqitur padi në gjykatë, duke pretenduar detyrimin e palës së paditur që t'i njohë bashkëpronarë mbi pasurinë objekt konflikti gjyqësor, regjistrimin e këtyre pasurive në ZVRPP sipas pjesëve takuese dhe zgjidhjen e pasojave juridike të kontratave të pavlefshme të lidhura midis të paditurve Pinari dhe një shoqërie ndërtimore.

2. Me vendimin nr. 3278, datë 1.4.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesëpadisë*”.

3. Me vendimin nr. 2857, datë 27.6.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 3278, datë 1.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurve trashëgimtarë të R.P. (V.P., H.P., B.K., B.I., L.T., Q.P., XH.P.) të njohin paditësen E.Q. bashkëpronarë për sipërfaqen e tokës prej 11.300 m² të përfutuar me AMT-në nr. 28 akti, për 1/5 pjesë të kësaj sipërfaqe. Detyrimin e të paditurve trashëgimtarë të R.P. (V.P., H.P., B.K., B.I., L.T., Q.P. e XH.P.) të njohin paditësit G.P., N.P., SH.T., L.SH., N.N. dhe N.P. bashkëpronarë mbi sipërfaqen 11.300 m² tokë bujqësore e fituar me AMT-në nr. 28 akti, bashkërisht për 1/5 pjesë të kësaj sipërfaqe, ose 1/6 e 1/5 secili. Regjistrimin e pjesëve takuese të këtyre sipërfaqeve në favor të paditësve në ZRPP-në Tiranë. Detyrimin e të paditurit B.P. të njohë paditësen E.Q. bashkëpronare për sipërfaqen e tokës prej 10.000 m² të fituar sipas VKM-së nr. 161, datë 8.4.1993, për 1/5 e saj. Detyrimin e të paditurit B.P. të njohë paditësit G.P., N.P., SH.T., L.SH., N.N. dhe N.P. bashkëpronarë për sipërfaqen 10.000 m² bashkërisht për 1/5 pjesë të saj. Regjistrimin e sipërfaqes prej 10.000 m² në ZRPP-në Tiranë në emër të paditësve sipas pjesëve takuese përkatëse të mësipërme. Detyrimin e të paditurit Q.P. të njohë paditësen E.Q. bashkëpronare për 1/5 pjesë të sipërfaqes 10.950 m² tokë bujqësore, të përfutuar sipas*



ligjit “Për tokën” dhe VKM-së nr. 161, datë 8.4.1993. Detyrimin e të paditurit Q.P. të njohë paditësit G.P., N.P., S.H.T., L.S.H., N.N. dhe N.P. bashkëpronarë bashkërisht për 1/5 pjesë të sipërfaqes së mësipërme prej 10.950 m². Regjistrimin e pjesëve takuese të paditësve mbi këto sipërfaqe në ZRPP-në Tiranë. Ndryshimin e pasojave juridike të rrjedhura nga zbatimi i kontratës së sipërmarrjes nr. 603 rep., nr. 141 kol., datë 27.1.2008, duke u detyruar të paditurit në këtë gjykim, trashëgimtarët e R.P. dhe B.P., si dhe shoqëria “Mateo Konstruksion” sh.p.k., t’i njohë paditësve E.Q. si dhe paditësve G.P., N.P., S.H.T., L.S.H., N.N. dhe N.P. të drejtën e përfutimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektin e ndërtuar në truallin objekt gjykimi – në raport me pjesët e tyre takuese të truallit në bashkëpronësi, të përcaktuara si më lart në këtë dispozitiv të vendimit.”. Kundër këtij vendimi pala e paditur në procesin civil ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, si edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

4. Me vendimin nr. 442, datë 25.11.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2857, datë 27.6.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me arsyetimin se përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Në lidhje me rekursin, me vendimin nr. 00-2017-414, datë 7.4.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

II

5. Kërkesit Xhavit Pinari, Nadire Pinari dhe Qazim Pinari i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1 Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë dhe parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit. Gjykimi në apel është zhvilluar pa pjesëmarrjen e palës së paditur, sepse nuk ka pasur dijeni për gjykimin dhe nuk i janë komunikuar ankimet e palës paditëse. Nënshkrimet për marrjen dijeni në aktet e komunikimit janë të falsifikuara, shkak për të cilin është bërë edhe kallëzim penal, megjithatë organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e çështjes penale me arsyetimin se për këtë pretendim duhet të shprehet gjykata, përderisa çështja është në gjykim. Edhe pse ky pretendim u ngrit në rekurs, ai nuk u mor parasysh.

5.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike. Ky parim vlen jo vetëm për respektimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, por edhe për respektimin e akteve administrative të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit, siç janë AMTP-të, përderisa këto akte janë në fuqi dhe i prodhojnë rregullisht efektet e tyre për sa kohë që nuk janë shfuqizuar ose ndryshuar nga organi administrativ apo me vendime gjyqësore të formës së prerë.

5.3 Ndërsa gjykata e shkallës së parë i ka qëndruar praktikës gjyqësore, Gjykata e Apelit, pa argumente faktike e ligjore dhe duke injoruar praktikën gjyqësore të konsoliduar, ka mbajtur një qëndrim diametralisht të kundërt dhe ka dhënë një vendim haptazi të padrejtë. I ndodhur para dy vendimeve të kundërta dhe në kushtet kur kishte vendosur pezullimin e ekzekutimit, Kolegji Civil duhej të vendoste shqyrtimin e çështjes në seancë.

5.4. Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është bërë një analizë e saktë dhe e plotë e provave të paraqitura dhe ato janë vlerësuar sipas vlerës provuese, duke u arritur në konkluzione të sakta e të drejta faktike. Në të kundërt, në vendimin e saj Gjykata e Apelit shprehet vetëm se tokat e fshatit Selitë janë përfshirë në ndërmarrjen bujqësore, por nuk ka përcaktuar se kur është krijuar ajo, kur i kanë kaluar tokat në pronësi, cila ishte përbërja e familjes bujqësore të trashëgimlënësit në atë kohë, cilët nga paditësit kanë qenë të punësuar në atë ndërmarrje, periudha e punësimit etj. Ajo nuk ka rrëzuar me kundërgjegjësi arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Ndaj ky vendim është alogjik dhe nuk është i qartë në formë dhe përmbajtje.

6. **Subjektet e interesuara, Eleni Qordja, Gaqo Prushi, Nuri Prushi, Shpresa Tafaj, Lumturi Shehu, Nadire Nunaj etj.** kanë prapësuar para Gjykatës si më poshtë:

6.1 Nëpërmjet vendimeve gjyqësore që përbëjnë objektin e kësaj kërkesë, kërkesve nuk i është cenuar asnjë e drejtë që garantohet nga ligji kushtetues.

6.2 Fakti që tre të paditurit nuk janë anëtarë të ndërmarrjes bujqësore “Gjergj Dimitrovi” është e vërtetuar nga librezat e tyre të punës.

6.3 Mungesa e këtij statusi juridik në momentin e daljes së ligjit për të tre kërkesit përcakton se kërkesa e parashtruar prej tyre nuk është e nivelit kushtetues.



6.4. Pretendimi se është formuar keq ndërgjyqësia është e gabuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesve

7. Kërkesit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimet e kërkesve për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor në thelb i referohen mënyrës së vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit nga ana e Gjykatës së Apelit. Duke qenë çështje me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, kërkesit nuk legjitimohen *ratione materiae* në lidhje me këtë pretendim.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve

9. Sipas kërkesve, gjykimi në apel është zhvilluar pa pjesëmarrjen e palës së paditur, ku bëjnë pjesë edhe ata vetë, dhe ata nuk kanë pasur dijeni për gjykimin, pasi nuk u janë komunikuar

ankimet e palës paditëse. Sipas tyre, nënshkrimet për marrjen dijeni në aktet e komunikimit janë të falsifikuara, shkak për të cilin është bërë edhe kallëzim penal. Edhe pse ky pretendim u ngrit në rekurs, ai nuk u mor parasysh nga Gjykata e Lartë. Subjektet e interesuara, Eleni Qordja, Gaqo Prushi, Nuri Prushi, Shpresa Tafaj, Lumturi Shehu, Nadire Nunaj etj., kanë prapësuar para Gjykatës se nëpërmjet vendimeve gjyqësore që përbëjnë objektin e kësaj kërkesë, kërkesve nuk i është cenuar asnjë e drejtë që garantohet nga ligji kushtetues.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtarë (*shih vendimin nr. 37, datë 30.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e



deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të këtij gjykimi rezulton se pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë pala paditëse në procesin gjyqësor (subjektet e interesuara) kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Sipas dëftësave të komunikimit të datës 12.6.2013 rezulton se ankimi i është komunikuar shoqërisht “Mateo Konstruksion”, Qerim Pinari etj., Bajram Pinari etj. dhe Nadire Pinari etj. Edhe pse këto akte janë nënshkruar, nuk rezulton se nga kush janë nënshkruar, pasi nuk është shënuar emri i personit të cilit i janë komunikuar, për më shumë nënshkrimi është i njëjtë për të tria dëftesat në emër të të paditurve. Sipas akteve të dosjes gjyqësore rezulton se në seancën e datës 24.6.2014 Gjykata e Apelit ka verifikuar pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse dhe pala e paditur (kërkuesit) ka qenë në mungesë. Gjykata, pasi ka verifikuar shkaqet e mosparaqitjes, ka vlerësuar se palët janë njoftuar rregullisht me shpallje (dhe pse në dosjen gjyqësore nuk rezulton i administruar ky akt) dhe se nuk ka shkaqe të arsyeshme për mosparaqitjen e palës së paditur. Për këtë arsye ajo ka vendosur ta gjykojë çështjen në mungesë së kësaj pale. Edhe në dy seancat gjyqësore të zhvilluara në datën 27.6.2014, gjykimi dhe më pas shpallja e vendimit janë bërë përsëri në mungesë të palës së paditur ose të përfaqësuesit të tyre.

14. Sipas nenit 447 të KPC-së ankimi u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në kreun IV, të titullit VI, të pjesës I, të këtij kodi, “Për njoftimet e thirrjet në gjykatë”. Për rrjedhojë, edhe në rastin e ankimeve zbatohen të njëjtat rregulla procedurale për njoftimin të zbatueshme edhe në shkallën e parë. Megjithatë, në rastin konkret nuk rezulton të jenë zbatuar këto rregulla për njoftimin e rregullt të palëve. Jo vetëm që nuk rezulton që në dosjen gjyqësore të jenë administruar dëftesat e komunikimit për secilën nga palët e paditura, por edhe në ato dëftesa të administruara nuk rezulton se kujt i janë komunikuar ato. Për më tepër, kërkuesit kanë paraqitur edhe kallëzim në prokurori, duke pretenduar se janë falsifikuar aktet e njoftimit, për të cilin me vendimin e datës 4.4.2015 të prokurorit është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

15. Po ashtu, në lidhje me njoftimin për ditën dhe orën e gjykimit neni 460 i KPC-së ka parashikuar se ai bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë. Sipas nenit 461 të po këtij kodi, mosparaqitja e palëve, për të cilat njoftimi është bërë me shpallje, nuk pengon shqyrtimin e çështjes, me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesën. Po sipas kësaj dispozite, gjykata nuk mund ta shqyrtojë çështjen në mungesë atëherë kur dëgjimi i palëve është një nga detyrat e rigjykimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt.

16. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, Gjykata konstaton se nuk është administruar asnjë akt në lidhje me mënyrën dhe datën e njoftimit të kësaj pale për seancën gjyqësore.

17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret mospjesëmarrja e kërkuesve në gjykim vë në dyshim respektimin nga ana e gjykatave të detyrimit për njoftimin e rregullt të palëve në procesin gjyqësor, çka bën që ky proces të jetë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

18. Ky pretendim është ngritur edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, megjithatë ai nuk është marrë parasysh nga ajo gjykatë dhe nuk i është dhënë përgjigje. Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e



Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e ka vlerësuar si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës Civile, nuk plotëson apo nuk korrigjon mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe të elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

19. Po ashtu, në jurisprudencën kushtetuese çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata ka theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 42, datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar edhe në vendimet gjyqësore të kundërshtuara, si dhe në pretendimet e kërkuarve vërehet se në rastin konkret gjykatat e faktit i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme konfliktit gjyqësor në fjalë. Për rrjedhojë, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe bazuar në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes civile në fjalë dhe se gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë në mungesë të palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuar, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

20. Sipas kërkuarve, parimi i sigurisë juridike vlen jo vetëm për respektimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, por edhe për respektimin e akteve administrative të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit, siç janë AMTP-të, përderisa këto akte janë në fuqi dhe i prodhojnë rregullisht efektet e tyre për sa kohë që nuk janë shfuqizuar ose ndryshuar nga organi administrativ apo me vendime gjyqësore të formës së prerë.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 28, datë 15.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar edhe se parimi i shtetit të së drejtës kërkon, gjithashtu, që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet jo vetëm me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individit ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike. Prandaj, Gjykata ka vlerësuar se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e tillë, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm që të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se kthimi i drejtpërdrejtë i pronës nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në rastet kur ajo shqyrton ankesat ndaj vendimeve të organeve administrative, nuk përbën tejkalim të juridiksionit gjyqësor (*shih vendimin nr. 28, datë 15.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).



22. Për sa më sipër, në rastin konkret, vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të AMTP-së nga ana e gjykatës nuk përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, për pasojë ky pretendim i kërkuësve është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 71/a dhe 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-414, datë 7.4.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo. Gani Dizdari,

VENDIM

Nr. 87, datë 26.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha,	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 5.10.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 46 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESI: Bardhyl Ibra

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësit, që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësi Bardhyl Ibra i është drejtuar më parë Gjykatës Kushtetuese me kërkesë me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2010-938, datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit; nr. 513, datë 24.5.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shpalljen e moskompetencës për gjykimin e çështjes administrative penale ndaj kërkuësit. Gjithashtu, kërkuësi ka pretenduar shfuqizimin e shprehjes “akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimi”, parashikuar në nenin 435/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP); të shprehjes “rekursi penal të nënshkruhet nga mbrojtësi, në të kundërt ai nuk pranohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë”, parashikuar në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.9.2009 të Kolegjeve të Bashkuara; të shprehjes “i pandehuri dhe palët private përfaqësohen nga mbrojtësit”, parashikuar në nenin 437/3 të KPP-së; të nenin 417 të Kodit të Procedurës Penale për të përcaktuar saktësisht kompetencën lëndore dhe tokësore.

2. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor lidhur me këto pretendime, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 51, datë 28.6.2011, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-



2010-938, datë 2.7.2010 të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

II

3. Kërkuesi Bardhyl Ibra në datën 9.6.2017 i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

4. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi parashikohet si subjekt nga nenet 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për legjitimitimin *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pretendim i cili hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

5. Gjykata Kushtetuese gjatë praktikës së saj, ka mbajtur qëndrimin se, në bazë të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon, mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga GJEDNJ-ja në vendimin e datës 23.10.2007 *Gjonboçari kundër Shqipërisë*, §.77, në të cilin është shprehur se sistemi juridik shqiptar nuk parashikonte një mjet të veçantë juridik të cilin kërkuesi mund ta kishte përdorur për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin *Marini kundër Shqipërisë* të datës 7.7.2008, §.154, si dhe në vendimin *Hamzaraj kundër Shqipërisë* të datës 3.2.2009, §.30. Në këtë kuptim, kërkuesi Bardhyl Ibra legjitimohet për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

6. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit të çështjes gjyqësore brenda afateve ligjore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

7. Bazuar në nenin 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjor ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata pretendimet e kërkesit lidhur me tejzgjatjen e gjykimit i shqyrton nën dritën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, të reflektuara edhe në praktikën e saj, pra referuar rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje.

i) Periudha e kohës që duhet marrë në konsideratë

9. Gjykata Kushtetuese i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Lartë për të marrë informacion për fazën e gjykimit në të cilën ndodhet çështja, për të cilën me shkresën përcjellëse nr. 25 akti, datë 30.11.2011 është dërguar vendimi nr. 51, datë 30.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese, duke i bashkëlidhur dhe kopjen e librit të dorëzimit të Postës Shqiptare. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 2533 prot., datë 21.6.2017, ka informuar se në librat e protokollit nuk gjendet asnjë informacion për hyrjen e vendimit nr. 51, datë 30.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

10. Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. B-18 Akti, datë 22.6.2017, i është drejtuar Postës Shqiptare për të marrë informacion lidhur me dorëzimin e zarfit nr. 25 Akti të Gjykatës Kushtetuese drejtuar Gjykatës së Lartë.



11. Posta Shqiptare, me shkresën nr. 1856/1 prot., datë 4.7.2017, ka sqaruar se afati për ruajtjen e dokumenteve për dorëzimin e objekteve është 2 vjet. Në këto kushte është i pamundur konfirmimi i dorëzimit të zarfit nr. 25 Akti i vitit 2011 të Gjykatës Kushtetuese.

12. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete në konsideratë do të merret data 17.12.2011 kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese është botuar në Fletoren Zyrtare.

ii) Komplexiteti i çështjes

13. Nga materialet e çështjes konkrete rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 266, datë 13.6.2008, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Përvetësimi i titullit apo detyrës shtetërore”, parashikuar nga neni 246/2 i K.P-së dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal ekzekutimi i vendimit me burgim është pezulluar për një afat prej 3 vjetësh, si dhe për një afat për 3 vjetësh i është hequr e drejta për të ushtruar veprimtari që kanë të bëjnë me profesionin e ndërmjetësit. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2010-129 (47), datë 16.2.2010, ka vendosur mospranimin e ankimit, pasi ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Në dosjen gjyqësore rezulton se në datën 12.3.2010 kërkuar ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan rekursin kundër vendimit nr. 10-2010-129 (47), datë 16.2.2010 lidhur me themelin e çështjes, por nuk rezulton asnjë vendim i Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e rekursit.

14. Kërkuar ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 513, datë 24.5.2010, ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes Gjykatës së Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2010-938, datë 2.7.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit. Ndaj këtij vendimi kërkuar ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 51, datë 30.11.2011, ka vendosur shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2010-938, datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

15. Gjykata vlerëson se rrethanat e çështjes janë krejtësisht të qarta dhe nuk i japin rastit natyrë komplekse. Zgjatja në kohë e kësaj çështjeje ka ardhur si rezultat mosfunksionimit të administratës gjyqësore, duke mos u justifikuar mosregjistrimi i çështjes dhe zgjatja e procesit për një periudhë kohore 6-vjeçare.

iii) Për sa i përket sjelljes së kërkuarit

16. Gjykata vëren se referuar kronologjisë së seancave, kërkuar ka shfaqur interes të vazhdueshëm pranë Gjykatës së Lartë për fazën në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes.

iv) Për sa u përket sjelljes së autoriteteve publike

17. Nga materialet e ndodhura në dosje dhe komunikimi i vazhdueshëm me Gjykatën e Lartë rezulton se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për rishqyrtimin e çështjes nuk është regjistruar, për këtë arsye çështja nuk është marrë në shqyrtim.

18. Konkretisht, nga dosja gjyqësore rezulton se në datën 21.9.2010 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan i ka dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan vendimin penal nr. 513, datë 24.5.2010. Me shkresën e datës 29.9.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan i ka dërguar Gjykatës së Lartë dosjen penale me objekt pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Me shkresën e datës 25.10.2010 Gjykata e Lartë i ka kthyer dosjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo e fundit, me shkresën e datës 3.11.2010, ia ka dërguar dosjen penale përsëri Gjykatës së Lartë, pasi sipas saj kërkuar ka bërë rekurs, por në dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur dërgimi i akteve Gjykatës së Lartë. Për nevoja të shqyrtimit të çështjes është kërkuar nga Gjykata Kushtetuese dosja gjyqësore, e cila, me shkresën nr. 326/1 prot., datë 13.7.2017, është vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

19. Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. B-18 akti, datë 13.6.2017, ka informuar Gjykatën e Lartë se vendimi nr. 51, datë 30.11.2011 i është dërguar me shkresën përcjellëse nr. 25 akti, datë 30.11.2011, duke i bashkëlidhur kopjen e librit të dorëzimit të Postës Shqiptare. Me shkresën nr. 2533/1 prot., datë 21.6.2017, Gjykata e Lartë ka informuar se lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk është gjendur asnjë informacion në librat përkatës të protokollit të Gjykatës së Lartë. Ndërsa me shkresën nr. 12.9.2017 ka



kërkuar vënien në dispozicion të vendimit nr. 51, datë 30.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të procedohet me regjistrimin e çështjes.

20. Gjykata thekson se bazuar në nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare, proces i cili prezumon marrjen dijeni për vendimin nga institucioni dhe zbatimin i tij, për më tepër kur objekt janë ankesat e individëve që kanë çuar në shfuqizimin e vendimeve të gjykatave.

21. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme.

22. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesit Bardhyl Ibra i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjyqimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtar kundër: Altina Xhoxhaj

URDHËR

Nr. 21, datë 28.12.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit në Gjykatën Kushtetuese, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Eugen Papandile.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

4. Ky urdhër hyn në fuqi në datën 1.1.2018 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bashkim Dedja

NJOFTIM

Nr. 19014, datë 20.12.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza II”, nënshkruar më 2.5.2017, hyrë në fuqi më 26.10.2017.



2. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Perusë për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të veçanta ose të shërbimit, nënshkruar në Nju-Jork, më 16.6.2017, hyrë në fuqi më 11.12.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë